



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE PRIVAT
ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT
"STRATI" Sh.p.k.



Adresa: Rr."Jordan Misja", P 141/1, Shk 1, Ap 7, Tiranë, Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com
Cel: Gentian Strati: 0674000450; Valter Kaçupi: 0674000456; Kozeta Guri: 0674000455; Edvin Malotaj: 0674000457

Nr. 5315

Nr. 2302 Prot.

Tiranë më 29.04.2022



Drejtuar : Qëndrës Kombëtare të Biznesit

Për dijeni : Shoqëria "Pjetraj Group" Sh.p.k

Adresa: Lezhë, Balldre, Nd. 1 katëshe, autostrada Lezhë-Shkodër, km 2,
Balldrë i Vjetër

ONE TELECOMMUNICATIONS Sh.A.

Në Tiranë, sot më datë 29.04.2022,

Unë **Kozeta Guri**, përmbaruese gjyqësore private pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "Strati" Sh.p.k., me NIPT L21825003E, e pajisur me certifikatë Nr. 83, datë Maj 2012, lëshuar nga Ministri i Drejtësisë, pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore, në zbatim të Vendimit Nr. 7194, datë 28.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,

KONSTATOVA:

Se në datë 17.03.2022, pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "Strati" Sh.p.k., është depozituar kërkesa e palës kreditore dhe është lidhur kontrata e shërbimit për ekzekutimin e Vendimit Nr. 7194, datë 28.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë:

Kreditor : ONE TELECOMMUNICATIONS Sh.A. (ish Telekom Albania Sh.A.)

Debitor : Shoqëria "Pjetraj Group" Sh.p.k

Me Objekt : *Kthim shume*

Me Vendimin Nr. 7194, datë 28.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur:

"Pranimin e kërkesës - padisë.

Detyrimin e palës së paditur Pjetraj Group shpk t'i paguajë palës paditëse shoqërisë "Telekom Albania" sh.a shumën 149,948 lekë, si detyrim i papaguar nga shërbimi telefonik celular.

Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të të paditurit".

Me shkresën Nr. 1559 Prot., datë 17.03.2022 debitorit i është komunikuar lajmërimi për ekzekutim vullnetar por nuk ka marrë asnjë masë për shlyerjen e detyrimit.

